

URDHËR
Nr.4/1, datë 24.5.2007

PËR MIRATIMIN E SHITESËS SË NJË VEPRIMTARIE FINANCIARE NË LICENCËN E
SUBJEKTIT FINANCIAR JOBANKË “CREDINS” SHA

Në bazë dhe për zbatim të nenit 53 pika 1 të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, të nenit 1 pika 3 dhe nenit 26 të ligjit nr.8365, datë 2.7.1998 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 9 pika 3 të Statutit të Bankës së Shqipërisë, miratuar me vendimin nr.100, datë 19.12.2000, të vendimit të Këshillit Mbikëqyrës nr.83, datë 8.10.2003 “Për miratimin e matricës “Për nivelin e vendimmarrjes së mbikëqyrjes bankare””, të nenit 8 dhe 13 të rregullores nr.96, datë 26.12.2003 “Për licencimin e subjekteve jobanka”, pasi u njoha me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes të datës 23.5.2007

URDHËROJ:

1. Miratimin e shtesës për kryerjen e veprimtarisë së qirasë financiare në licencën nr.4, datë 13.6.2007 të subjektit financiar jobankë “Credins” sh.a.
 2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për njoftimin e këtij vendimi subjektit financiar jobankë “Credins” sh.a.
 3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritetit Europian dhe Komunikimit për publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

GUVERNATORI I BANKËS SË SHQIPËRISË
Ardian Fullani